



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE PEJË**

---

**AD/GJTHPE/.nr.1/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit M.K, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga R.L, nga fshati B., Komuna I., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 26.01.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e parashtruar nga R.L, nga fshati B., Komuna I., ndaj gjyqtarit M.K, **SI E PABAZUAR.**

**A r s y e t i m**

Me datë 22.01.2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke vepruar konform nenit 9 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë te autoritetit kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga R.L, nga fshati B., Komuna I., ndaj gjyqtarit M.K, për shkak të performancës së dobët me arsyetimin se në vitin 2019 në Gjykatën Themelore në Pejë ka dorëzuar padi me bazë juridike kompensim dëmi, ku palë paditëse është këtu parashtruesi i ankesës, ndërsa palë të paditura kanë qenë K.dhe Komuna e Pejës dhe lidhur me këtë lëndë mbi dhjetë herë ka dorëzuar kërkesa për caktimin e seancës, mirëpo gjyqtari nuk ka caktuar asnjë seancë ndërsa, cakton lëndë të vitit 2024. Me datë 04.12.2023, gjyqtari ka marrë Aktvendim me të cilin K.është heqë si palë e paditur dhe ka mbetur vetëm Komuna e Pejës andaj, mbi bazën e të lartcekurave ka propozuar që ndaj gjyqtarit M.K të merren masa disiplinore. Si provë ankesës së tij disiplinore ia ka bashkëngjitur Aktvendimin C.nr.2493/22, të datës 04.12.2023 dhe kërkesat e datave 13.09.2022 dhe 06.11.2023 për caktim të seancës në lëndën C.nr.2493/22.

Me datë 23.01.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga R.L ndaj gjyqtarit M.K.

Gjyqtari M.K në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka deklaruar se kërkesëpadija e paditësit këtu parashtruesit të ankesës, është me bazë juridike kompensim dëmi, pa kërkesë për masë të përkohshme e as të sigurimit dhe si e tillë nuk është me prioritet ligjor. Fillimisht, ka sqaruar se lëndën e ka pranuar në punë me datë 22.02.2023, pas përjashtimit të gjyqtarës paraprake e cila në vitin 2021 kishte ndërprerë procedurën në këtë çështje dhe pas shqyrtimit paraprak të saj, me Aktvendimin e datës 04.12.2023, jashtë seancës, e ka hedh pjesërisht padinë si të palejueshme, vendimin në fjalë i autorizuari i paditësit e ka pranuar me datë 05.12.2023 dhe nuk ka ushtruar ankesë brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh. I njëjti ka theksuar se ankesa disiplinore e parashtruar ndaj tij nuk përmban asnjë arsyetim ligjor se cilat janë shkeljet disiplinore që pretendon se janë bërë nga ana e tij si gjyqtar, nuk ka asnjë provë konkrete se ka performancë të dobët e po ashtu, nuk ka bashkëngjitur asnjë provë se ka caktuar lëndë të kësaj natyre të këtij viti, duke përjashtuar lëndët e vitit 2022 që kanë të bëjnë me rastet sipas prioritetit ligjor. Sa i

përket çështjeve të tjera të pretenduara në parashtresë, gjyqtari ka theksuar se i ka arsyetuar në Aktvendimin e datës 04.12.2023 dhe të njëjtat, mund të jenë pretendime që mund të atakohen me mjetin e rregullt juridik andaj, konsideron se kjo ankesë nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve apo në Kodin e Etikës.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit M.K, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore nuk është e bazuar.

Nga theksimet në parashtresë rezulton se parashtruesi i ankesës ka parashtruar ankesë për shkak të performancës së dobët të gjyqtarit me arsyetimin se disa herë ka dorëzuar kërkesa për caktim të seancës dhe nuk ia ka caktuar ndërsa, cakton seanca në lëndë të tjera më të reja e po ashtu, për faktin se gjyqtari jashtë seancën ka marrë Aktvendim për hedhje si të palejuar padinë e parashtruar ndaj njëres palë të paditur.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se gjyqtari ka performancë të dobët për shkak se nuk ia ka caktuar seancën edhe pse disa herë i është drejtuar me kërkesë, autoriteti kompetent gjen se pretendimi i tillë nuk hynë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore për aq kohë sa i njëjti, me asnjë provë nuk e ka argumentuar faktin se gjyqtari ka trajtuar lëndë të tjera të natyrës së njejtë e që janë më të reja se lënda e këtu parashtruesit të ankesës. Në këtë pikë, autoriteti kompetent e vlerëson të arsyeshme të sqarojë se seancat gjyqësore caktohen sipas radhës së pranimi të lëndëve në gjykatë me përjashtim të lëndëve të cilat sipas ligjit konsiderohen si procedura urgjente dhe për të cilat vlejné afatet jo të rregullta.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se gjyqtari ka kryer shkelje të natyrës disiplinore për shkak se ka marrë aktvendim me të cilin e ka hedh poshtë si të palejuar padinë e parashtruar ndaj njëres të paditur, autoritetit kompetent gjen se, pretendimi i tillë është pretendim ankimor që ka mundur të shfrytëzohet për të parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, si gjykatë kompetente për të vendosur ndaj ankesave të palëve të pakënaqur me vendimet e gjykatës së shkallës së parë, e jo pretendim për të parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit aq më pak, i paargumentuar me prova që do të dëshmonin se gjyqtari vendimin e tillë e ka nxjerrë në shkelje të Kodit të Etikës apo shkelje disiplinore të përcaktuar me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.1/24, me datë 26.01.2024**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit M.K*
- 3. Parashtruesit të ankesës – R.L, fshati B., Komuna I.*